



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3877 / Prot.

3

Rrëshen me, 29 . 12 . 2025

V E N D I M

Nr. 99 datë 29. 12. 2025

**PËR
"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",
BASHKIA MIRDITË.**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit 2025", në Vendimin nr. 115, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", Kërkesës për Financim nr. 3877 prot. datë 24.09.2025, nga Shoqata e Invalidëve Tetraplegjik - dega Mirditë, së bashku me relacionin nr. 3877/1 prot, datë 23.12.2025 dhe projekt-vendimin e Kryetarit Bashkisë, shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 29.12.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën **40 000**, (dyzet mijë) lekë, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
+ T'i akordojë ndihmë financiare Shoqatës të Invalidëve Tetraplegjik, dega Rrëshen.
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;...**40 000** lekë.
 - b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....**40 000** lekë.
2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet; Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



ADRESA: SHËSHI "ABAT DOK" RRËSHEN

KRYETAR

Aleksandër PICAKU

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 3877/2 Prot.

Rrëshen, më 23.12.2025

P/V E N D I M

Nr. III datë 23.12.2025

“PËR PËRDORIM FOND REZERVË”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, në ligjin Nr.68/2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, në ligjin Nr.115/2024, ‘Për buxhetin e vitit 2025’ ‘Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 ‘Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit’, në udhëzimin Nr.2 datë 24.01.2025, ‘Për zbatimin e buxhetit 2025’, në VKB Nr.115 datë 27.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2025’, në kërkesën Nr.4252 Prot dt.11.11.2024, në Kërkesën Nr.3877 prot, datë 24.09.2025 SHIP&TSH Dega Rrëshen si dhe në relacionin Nr.3877/1 dt.23.12.2025 te sektorit të shërbimit social te NJA Rrëshen, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkisë:

V E N D O S I :

I-Të miratojë përdorimin e fondit Rezervë në shumën 40 000 (Dyzetë mijë) lekë .) për dhënie ndihmë financiare si më poshtë:

1.T’i akordojë ndihmë financiare, Shoqata e Invalidëve Para & Tetraplegjik Dega Rrëshen .

a-Paksim : Fondi rezervë (AII33 00 2133001 01 V491AAA.604) për shumën 40 000 lekë

b-Shtohet;(AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën40 000 lekë

2.Pagesa të kalojë në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.

II- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë (Drej.Zhv.Ek.Tat.Taksave).

III-Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksandër PICA KU

Paraqitën projektin

Dr/zhvill ek dhe tatim taksat:

V.Gjoka

Përgj.sek.juridik & prokurimeve

M.Topollaj

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel&fax :+3552162223 web web:www.bashkiamirdite.gov.al

KËRKESË

Nr. 3877 Prot
Dt. 24.09.2025

Drejtuar:

BASHKISË MIRDITË

Për dijeni:

**KRYETARIT ALBERT MËLYSHI
KËSHILLIT BASHKIAK**



Para disa ditësh Z.Hysi Hysni qytetar nga Kosova me banim në Gjermani, ka dhuruar 7 karroca për personat me aftësi të kufizuar. Një grup të rinjsh nga Mirdita kanë bërë pagesën e transportit të karrocave e cila është 350 euro.

Pas komunikimeve me Z.Hysni, na u bë e ditur se është i gatshëm të na dhurojë edhe 8 karroca të tjera dhe 2 aparatura oksigjeni.

Nisur nga kjo, kërkoj ndihmën e bashkisë Mirditë për të mbuluar koston e transportit e cila është 350 euro, ashtu siç e kam cituar edhe më lart. Pres përgjigje sa më të shpejtë nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, me respekt,

KRYETAR I SHOQATËS SË TETRAPLEGJIKËVE MIRDITË

ARBEN MARGJINI



BASHKIA MIRDITË
AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr. 3877 / Prot.

Rrëshen, më 23.12.2025

Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare

Drejtuar: Drejtorisë së Financës

Lidhur me shkresën e ardhur në Bashkinë Mirditë, më 24.09.2025, me nr Prot. 3877, e dërguar nga kryetari i Shoqatës së Para dhe Tetra Plegjikëve, Z.Arben Margjini, për kërkesën për ndihmë financiare për pagesën e rrugës për transportin e 8 (tetë) karrocave, ju japim relacionin si më poshtë:

Shoqata në fjalë ushtron aktivitetin e saj në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe lehtësimin e integritetit të tyre shoqëror. Karrocet janë mjete thelbësore për lëvizshmërinë dhe pavarësinë e këtyre personave, ndërsa transporti i tyre përbën një kosto që shoqata e ka të pamundur ta përballojë me burimet e veta.

Duke marrë parasysh:

- karakterin social dhe human të kërkesës,
- rëndësinë që kanë këto mjete për përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara,
- si dhe mundësitë ligjore dhe buxhetore të institucionit,

vlërohet se plotësimi i kësaj kërkesë është i arsyeshëm dhe në përputhje me politikat e mbështetjes sociale.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i ndihmës financiare për mbulimin e shpenzimeve të transportit të 8 karrocave për persona me aftësi të kufizuara, sipas procedurave në fuqi.

Konceptoi: Adela Gjikota

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni